# DËSHMI ARKIVI

**A-452642**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Selena Gomez i përgjigjet nostalgjisë për pamjen e saj në 2016! “Kjo thjesht nuk…” \| Top Albania Radio |
| ADRESA | `https://www.topalbaniaradio.com/selena-gomez-i-pergjigjet-nostalgjise-per-pamjen-e-saj-ne-2016-kjo-thjesht-nuk/` |
| BURIMI | topalbaniaradio.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 17 shtator 2026, 14:48:02 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 17 shtator 2026, 14:34:40 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `3e4a5a095609a029e4343df75ea6a38e20fa9c27458f29c5e2656e17eb566dee` |
| TEKSTI | `05980cb135c37b762a4c42e2f583f805976f4239c6e4ec6c740926b15e5ea915` |
| PAMJA | `9157a458f76b6f480b531d3f2c8bed0282307589957d2e1df5f4c3c16dc45d2d` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `06f3655f50d6b33e91f2823e4e83c486698d3f383abfaaa4d7b80fcb7cb5745a` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `dc0b234c87b6bef6f484ef22e44d5789ea8bfa692c7eb14dae36a548c590e2a2` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/06f3655f50d6b33e91f2823e4e83c486698d3f383abfaaa4d7b80fcb7cb5745a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Celebrities Gossip Showbiz

# Selena Gomez i përgjigjet nostalgjisë për pamjen e saj në 2016! "Kjo thjesht nuk…"

*Redaksia K*

*17 Shtator 2026*




**Selena Gomez nuk ka** ndërmend të rikthehet pas në kohë vetëm për t'iu përshtatur pritshmërive të publikut. Në një intervistë të re për People, këngëtarja dhe aktorja foli hapur për plakjen, ndryshimin e stilit të saj dhe nostalgjinë e fansave për versionin e saj të vitit 2016.

Fotografitë e **Gomez** nga ajo periudhë vazhdojnë të rikthehen vazhdimisht në rrjetet sociale, veçanërisht ato ku ajo shfaqet me look-un karakteristik me "smoky eye". Por, sipas vetë artistes, disa njerëz duket se duan ta "ngrijë" në atë periudhë dhe ta shohin gjithmonë njësoj.

> *Duhet të jem e sinqertë, rikthimet e vitit 2016 dhe gjithçka rreth tyre janë shumë argëtuese, por njerëzit bëhen vërtet intensivë. Gjithmonë bëj shaka se mendoj që njerëzit duan të më ngrijnë në kohë në atë periudhë të jetës sime*

-tha Gomez.

Ajo pranoi se 2016 ishte një periudhë shumë e ngarkuar për të. Në atë kohë, **Selena** ishte vetëm 23 vjeçe dhe ndodhej në një nga fazat më të ekspozuara të karrierës së saj. Albumi "Revival" kishte sjellë disa prej hiteve të saj më të mëdha, ndërsa ajo ishte gjithashtu ndër personazhet më të ndjekura në Instagram.

Duke kujtuar pamjen e asaj kohe, Gomez foli edhe për grimin që u bë një nga karakteristikat e saj të asaj periudhe.

> *Sigurisht që duhej të bëja smoky eye. Po përpiqesha të dukesha cool!*

-tha ajo me humor, duke shtuar se sot e përdor ende këtë stil, por në një mënyrë tjetër.

**Mesazhi i saj për a**ta që presin rikthimin e asaj Selena-s ishte i qartë: ajo ka ndryshuar dhe nuk ka ndërmend të ndalojë kohën.

> *Unë mendoj se njerëzit gjithmonë duan që të dukem siç dukesha atëherë, dhe kjo thjesht nuk do të ndodhë. Ndonjëherë njerëzve nuk u pëlqen pamja e bukurisë natyrale, por kjo është pikërisht ajo që përfaqëson identitetin tim tani, të lidhem më shumë me bukurinë natyrale*

-u shpreh ajo.

34-vjeçarja tha gjithashtu se nuk e tremb aspak plakja. Përkundrazi, ajo e përshkroi këtë fazë të jetës si diçka që po e shijon.

> *Të plakesh ka qenë shumë argëtuese. Nuk kam aspak frikë. Më pëlqen të plakem*

-tha Gomez, duke pranuar me humor se me kalimin e viteve trupi ndryshon, por theksoi se për sa kohë je gjallë, mosha mbetet vetëm një numër.

Në intervistë, Selena foli edhe për motrën e saj 13-vjeçare, Gracie, për të cilën tha se ka shumë më tepër vetëbesim sesa kishte ajo në atë moshë.

Ndërkohë, sot Gomez është në një fazë tjetër të jetës, si në aspektin profesional, ashtu edhe personal. Ajo është themeluese e Rare Beauty dhe vazhdon të fokusohet te një qasje më natyrale

ndaj bukurisë, ndërsa puna e saj për shëndetin mendor është bërë një pjesë e rëndësishme e imazhit dhe angazhimit të saj publik. Fondi Rare Impact ka mbledhur më shumë se 30 milionë dollarë për organizata që mbështesin shëndetin mendor të të rinjve.

Në fund, duket se Selena Gomez nuk është e interesuar të rikrijojë veten e vitit 2016. Ajo mund t'i shijojë kujtimet dhe nostalgjinë e fansave, por versioni i saj i sotëm është pikërisht ai që dëshiron të jetë.

**LAJME TË NGJASHME**



Selena Gomez do të bëhet nënë? Bashkëshorti i saj Benny Blanco jep sinjalin...

1 MIN




Selena Gomez shkëlqen si një statujë e artë në Emmy!

2 MIN




Selena Gomez shet vilën e saj në Kaliforni, sa shkoi vlera?

1.5 MIN



Selena Gomez dhe Benny Blanco shijojnë romancën në Venecia!

1 MIN



U akuzua për mashtrim, reagon e indinjuar Selena Gomez!

1 MIN

**MË TË LEXUARAT**



Të paguhesh për të lexuar, kjo po ndodh në Singapor!



Papa Leoni XIV paralajmëron për rrezikun e Inteligjencës Artificiale!



Majko përlotet pas vendimit për ish-liderët e UÇK: Dramë njerëzore e jashtëzakonshme, mund të cenojë historinë!



Lorenc Hasrama: "Kam zgjedhur të jap më të mirën, festivalet..."



Nga Guardian te Reuters dhe Al Jazeera, çfarë shkruajnë mediat ndërkombëtare për vendimin e Gjykatës së Hagës për liderët e UÇK-së



Trupi gjykues: Të katërt ish-anëtarët e UÇK-së penalisht përgjegjës për krime lufte



LAJMI I FUNDIT/ Kadri Veseli dënohet me 18 vite burg



Ish-presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dënohet me 25 vjet burgim për krime lufte



Haga/ Krasniqi dënohet me 25 vite burgim



Rexhep Selimi dënohet me 13 vjet burgim

## EDITORI SUGJERON



"Prej pesë vitesh duam një fëmijë…"/ Çiljeta Xhilaga zbulon planet me Albanin: Kam menduar të bëj in vitro!



"Të kisha çerekun e egove të kolegeve të mia…"/ Çiljeta Xhilaga: Nuk kam vuajtur për vëmendje!



10 shenjat që tregojnë se ushqimi duhet të hidhet para se të...




Pjeshkat apo bananet?! Cili frut është më i mirë për sheqerin në gjak dhe kaliumin…



10 pjesët më të mira të mishit të viçit për proteina me pak yndyrë!



Pilula eksperimentale imiton hormonin që prodhohet gjatë aktivitetit fizik intensiv!




Çfarë nuk duhet të mungojë në dietën tuaj për flokë të shëndetshëm...



Lorenc Hasrama risjell këngën e Flori Mumajesit live në studio!



Lorenc Hasrama kujton situatën më qesharake që i ka ndodhur në koncert!



Cili ka qenë përfaqësimi më i mirë në "Eurovision" sipas Lorenc Hasramës…

**RRETH NESH**

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

**KONTAKT**

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:
[email protected]

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

**COPYRIGHTS**

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

**LINKS**

- Kontaktoni
- Marketing
- Frekuencat
- Aksesueshmëria
- Mundësi Punësimi
- Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for tabnav widget to work properly.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.